



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV**

Nr. AG1/3 prot.

Tiranë më 27.03.2018

**REKOMANDIM**

Nr. 10, datë 27.03.2018

**PËR KONTROLLUESIN "ENVIRONMENTAL MANAGEMENT  
CONSULTANTS SHPK"**

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 31 pika 1, gërma a/1 dhe 32 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit Nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "Environmental Management Consultants shpk",

**KONSTATOVA SE:**

Në zbatim të Urdhrit Nr.89 datë 07.03.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit Shoqëria "Environmental Management Consultants shpk", me objekt kontrolli:

- Zbatimi i Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit Shoqëria "Environmental Management Consultants shpk".

Në funksion të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Shoqëritë e vlerësimit të pasurive të paluajtshme, janë kontrollues të cilët mbledhin dhe përpunojnë të dhëna personale të kategorive "punonjës dhe klientë".

Kontrolluesi Shoqëria "Environmental Management Consultants shpk", është subjekt juridik me NIPIT: K81317002P dhe objekt aktiviteti "Vlerësim asetesh pasuri e paluajtshme, ekspertizë, studim tregu imobiliar etj...".

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi, sipas procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim në datë 13.03.2018, u konstatua se:

1. Kontrolluesi nuk ka "Njoftuar" në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të ligjit. Më datë 13.03.2018, mbas marrjes dijeni nëpërmjet urdhrin për kryerjen e hetimit administrativ, kontrolluesi ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit "Formularin e Aplikimit" për realizimin e "Njoftimit";
2. Kontrolluesi nuk ka hartuar rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, por është në proces të certifikimit "ISO 14001", ku përveç të tjerave përcaktohen rregulla për mbrojtjen e të dhënave personale;
3. Kontrolluesi nuk ka nënshkruar "Deklaratë Konfidencialiteti" me punëmarrësit të cilët kanë akses në përpunimin e të dhënave personale, por në kontratat individuale të punës, në rubrikën "Përgjegjësitë e punëmarrësit" është parashikuar detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit;
4. Kontrolluesi në kontratat me të tretë, me objekt: ofrimin e shërbimeve të vlerësimit të pronës, parashikon detyrimin për ruajtje të konfidencialitetit, por këto kontrata nuk janë hartuar sipas Aneksit nr. 1 të Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit, datë 03.08.2012 mbi "Rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi."

Në përfundim të procesit të hetimit administrativ, grupi i kontrollit hartoi proces verbalin, i cili u lexua në prani të palëve. Përfaqësuesi i kontrolluesit e nënshkroi duke u shprehur se do të realizojë menjëherë detyrimet ligjore, për hartimin rregullores specifike për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe nënshkrimin e deklaratave të konfidencialitetit me punëmarrësit.

Faktet e mësipërme (mungesa e rregullores për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, mungesa e "Deklaratës së Konfidencialitetit" me punëmarrësit të cilët kanë akses në përpunimin e të dhënave personale dhe mos hartimi i kontratave me të tretë, për ofrimin e shërbimeve të vlerësimit të pronës, sipas formatit të Aneksit nr. 1 të Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit), përbëjnë shkelje të dispozitave të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Nisur nga fakti që kontrolluesi u tregua bashkëpunues me grupin e kontrollit si dhe tregoi gatishmëri për riparimin e menjëhershëm të shkeljeve të konstatuara, Zyra e Komisionerit vlerëson se dalja me akt rekomandues plotëson më së miri përfundimin e këtij kontrolli.

Sa më sipër:

Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

#### **REKOMANDOJ:**

1. Në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, kontrolluesi Shoqëria "Environmental Management

- Consultants shpk*", të hartojë rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.
2. Në zbatim të nenit 28 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, kontrolluesi Shoqëria "*Environmental Management Consultants shpk*", të nënshkruajë "*Deklaratë Konfidencialiteti*" me punëmarrësit që kanë akses në të dhëna personale.
  3. Në zbatim të nenit 20 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, kontrolluesi Shoqëria "*Environmental Management Consultants shpk*", të hartojë kontratat me të tretë, për ofrimin e shërbimeve të vlerësimit të pronës, sipas formatit të Aneksit nr. 1 të Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit, datë 03.08.2012 mbi "*Rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi.*".
  4. Kontrolluesi Shoqëria "*Environmental Management Consultants shpk*", të realizojë plotësimet e detyrimeve të parashikuara në këtë Rekomandim, brenda afatit 10 ditor nga momenti i marrjes dijeni.
  5. Përbushja e këtyre detyrimeve nga kontrolluesi Shoqëria "*Environmental Management Consultants shpk*", përbën objekt kontrolli të vazhdueshëm nga Zyra e Komisionerit në kuadër të kompetencave ligjore.
  6. Në rast mos përbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 27.03.2018

